



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik  
-Kuvendi i Komunës-

01Nr.470/03-16853/22  
Kaçanik, 27.06.2022

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 27 qershor 2022, pos tjerash;

### NJOFTOHET

1. Me Raportin e Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2021.

2. Në Raportin si në pikën 1 të kësaj shkrese janë paraqitur çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin 2021, i cili përfshinë Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Vjetore Financiare dhe Rekomandimet nga të gjeturat e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese është; “Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin 2021” / lënda 01Nr.470/03-16853/22.

**Më këtë shkrese njoftohen:** Kryetari i Komunës , Drejtorja e Buxhetit dhe Financave dhe Arkivi.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

**Zyra e Kryetarit**

01 Nr. 170/18-16853/22  
Kaçanik; 17.06.2022

PËR/ZA/TO:	ZYREN E KUVENDIT KOMUNAL – KRYESUESIT Z. KEMAJL MËRSELI
NGA/OD/FROM:	Besim Ilazi – Kryetar Komune-ZKA
PËRMES:	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Dorëzimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2021


**Të nderuar,**

Bashkëngjitur me këtë shkresë po iu dergojmë Raportin e Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare 'PVF' Komunës së Kaçanikut për vitin 2021 për shqyrtim dhe diskutim në seancën e ardhshme e cila do të zhvillohet nga Asambleja Komunale.

**Me respekt;**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE  
TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN 2021**

Prishtinë, qershor 2022

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kaçanikut (KK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- C1 Detyrimet kontingjente të prezantuara në nenin 18 në Raportin Vjetor Financiar (RVF) ishin të nënvlerësuara për 414,546€;
- A1 Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë 104,879€; dhe
- A2 Pasuritë kapitale të prezantuara në nenin 19.3.1 në RVF ishin të mbivlerësuar për 101,407€.

*Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Kaçanikut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A3 Komuna te dy kontrata publike kornizë të lidhura me çmim për njësi kishte bërë tejkalimin e tyre në vlerë 153,195€;
- A4 Komuna në katër raste kishte lëshuar dokumentacionin e tenderit pa hartuar projektin ekzekutues; dhe
- C2 Komuna nuk kishte arrit të bëjë inspektimin (verifikimin) e 20% të pronave.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Kaçanikut.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Kaçanikut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Kaçanikut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Kaçanikut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Kaçanikut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.



## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: Tejkallim i kontratave publike kornizë, mungesë e projekteve ekzekutive, prezantim jo i drejtë i detyrimeve kontingjente, keqklasifikim i shpenzimeve, dobësi në regjistrimin e pasurive. Po ashtu, procesi i raportimit në komunë është përcjellë me mangësi, kjo është vërejtur sidomos me rastin e përgatitjes së Raportit Vjetor Financiar (RVF). RVF i Komunës i përgatitur me datë 31.01.2022 për vitin e përfunduar me 31.12.2021, nuk ishte në pajtim me Rregullën Financiare nr. 01/2017. Raporti ishte jo i saktë. Pas sugjerimeve nga auditimi, RVF është korrigjuar dhe dorëzuar në ZKA dhe çështjet e ngritura nga ne janë korrigjuar, përveç çështjeve të raportimit të saktë të detyrimeve kontingjente dhe keqklasifikimit të shpenzimeve të cilat kanë ndikuar në kualifikimin e opinionit të auditimit.

Gjetjet dhe rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë informacionin financiar të paraqitur në Raportin Vjetor Financiar, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, një (1) i përsëritur dhe dy (2) tjera pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja A1 - Keqklasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike

##### Gjetja

Udhëzim Administrativ MF-nr.04/2019 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale parasheh se "Data kur asetit është për herë të parë i gatshëm për përdorim dhe në gjendje të përdoret siç është menduar është data e komisionimit (pranimi teknik) të asetit. Nga kjo datë, shpenzimet e operimit, riparimit dhe mirëmbajtjes konsiderohen si shpenzime rrjedhëse" Po ashtu, neni 18, paragrafi 3 i Rregullës Financiare nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se "shpenzimet duhet të jenë në kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t'i aplikojnë".

Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë 104,879€. Nga kjo vlerë:

- nga kategoria investimet kapitale janë paguar 87,562€, për mirëmbajtjen teknike të objekteve komunale dhe riparimin e objekteve shkollore, të cilat sipas udhëzimit konsiderohen mallra dhe shërbime;

- nga kategoria mallra dhe shërbime vlera prej 15,637€, ishte paguar nga Thesari sipas vendimit përmbarimor për shpronësimin e tokës shpenzime këto që i takojnë kategorisë investime kapitale; dhe

- nga kategoria mallra dhe shërbime janë paguar 1,680€, për pagat e arsimtarëve të angazhuar gjatë pandemisë Covid-19.

Këto kishin ndodhur për shkak të planifikimit jo të mirë buxhetor dhe mungesës së mjeteve në kategoritë adekuate.

- Ndikimi** Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpien në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të Komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-ve.
- Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve më pas të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

#### **Çështja A2 - Regjistrimet e gabuar të pasurive kapitale**

- Gjetja** Rregullorja MF-Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, Neni 6 paragrafi 1 përcakton se "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël" po ashtu, Neni 6 paragrafi 3 përcakton se "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Pasuritë kapitale të prezantuara në nenin 19.3.1 në RVF ishin të mbivlerësuar për 101,407€, pasi që pagesat e mëposhtme ishin regjistruar si pasuri kapitale ndonëse i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime.

Pagesat në vlerë 56,999€ dhe 17,084€ për renovimin e objekteve shkollore, pagesa në vlerë 13,479€ për renovimin e objekteve banesore, pagesa në vlerë 6,695€ për furnizim me oxygen concentrator, pagesa në vlerë 5,990€ për furnizim me inventar për shkolla dhe pagesa në vlerë 1,160€ për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave.

Mbivlerësimi i pasurive kapitale ka ndodhur pasi që zyrtari i pasurisë gabimisht i kishte regjistruar si pasuri kapitale në SIMFK, pasuritë që nuk e plotësojnë kriterin për të qenë pasuri kapitale.

- Ndikimi** Regjistrimet e gabuara, kanë ndikuar në mbivlerësimin e pasurisë që njëkohësisht ka reflektuar edhe në prezantimin e informatave jo të sakta në pasqyrat financiare.
- Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja C1 - Nënvlërësimi i detyrimeve kontingjente**

**Gjetja** Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Detyrimet kontingjente të prezantuara në nenin 18 në Raportin Vjetor Financiar (RVF) janë paraqitur në vlerë 100,511€, derisa sipas regjistrit të mbajtur nga përfaqësuesi ligjor i Komunës kishin vlerën 515,057€. Kjo situatë tregon se detyrimet kontingjente ishin të nënvlerësuara për 414,546€.

Paraqitja e detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ka rrjedhur si rezultat i të kuptuarit jo të drejtë të kërkesës së rregullës nga përfaqësuesi ligjor i Komunës, i cili me rastin e përgatitjes së RVF kishte ofruar vetëm regjistrin e detyrimeve kontingjente me pretenduesit për të cilat priten që kontestet gjyqësore të zgjidhen brenda vitit 2021.

**Ndikimi** Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e RVF-së të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën detyrimeve kontingjente.

**Rekomandimi C1** Kryetari duhet të sigurojë se përfaqësuesi ligjor i Komunës me rastin e përgatitjes së RVF do t'i ofroj tek financat regjistrat e plotë të detyrimeve kontingjente.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A3 - Tejkallim i kontratës publike kornizë

#### Gjetja

Pika 56.15 e Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh "Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit " artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. Në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi".

Te dy kontratat publike kornizë të lidhura me çmim për njësi kemi identifikuar, se pagesat totale për projektet kanë tejkallim të vlerës së kontraktuar. Tejkallimet janë vërejtur te kontrata "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale" e lidhur me 15.11.2019, në vlerë 450,000€, tejkallimi ishte në vlerë 134,930€, dhe te kontrata "Rregullimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit vertikal dhe horizontal" e lidhur me 21.11.2019, në vlerë 70,000€, tejkallim ishte në vlerë prej 18,265€.

Tejkallimi i kontratave kishte ndodhur për shkak se zyra e prokurimit me rastin e hartimit të kontratave gabimisht e kishte paraparë në kontratë aplikimin e pragut apo tavanit plus/minus tridhjetë përqind (30%).

#### Ndikimi

Tejkallimi i vlerës së kontraktuar nuk është në pajtim me kriteret e përcaktuara për kontratat me çmime për njësi, si dhe rezulton me pagesa përtej buxhetit të planifikuar për ato projekte dhe mund të ndikon në realizmin e projekteve tjera të planifikuara.

#### Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit me rastin e hartimit të kontratave do t'i respektoj kriteret e parapara ligjore, në mënyrë që në asnjë rast të mos tejkalohet vlera e kontratave.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A4 - Mungesa e projektit ekzekutues

#### Gjetja

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik respektivisht pika 20.13 ndër tjerash parasheh se "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit".

Në katër (4) raste kemi vërejtur se Komuna ka lëshuar dokumentacionin e tenderit pa hartuar projektin ekzekutues. Rastet ishin tek kontratat: Ndërtimi i shtegut të çiklistëve dhe trotuarit në fshatin Shtrazë në vlerë 86,167€, Rregullimi i trotuarit Bob-Doganaj në vlerë 134,334€, Rregullimi i

ndriçimit Publik në vlerë 73,555€, dhe Rehabilitimi i rrugës Qamil Ilazi dhe Sali Bajra, në vlerë 259,937€.

Kjo ka ndodhur nga pakujdesia e Komunës për të hartuar projektin ekzekutues ashtu siç kërkohet me kërkesat ligjore.

**Ndikimi** Mungesa e projektit ekzekutues mund të shkaktoj vështirësi në realizimin e projekteve gjatë fazës së ekzekutimit, dhe rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

**Rekomandimi A4** Kryetari të sigurojë kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I

**Çështja C2 - Mosverifikimi i plotë i pronave komunale**

**Gjetja** Nenit 15 i Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme parasheh që Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha pronave.

Komuna e Kaçanikut kishte faturuar Tatimin në Pronë nga sistemi i Protax për objekte 9105 fatura. Komuna në vitin 2021 kishte arritur të bëjë inspektimin (verifikimin) e 550 objekteve apo rreth 6% të objekteve.

Verifikimi i ulët i pronave ka ndodhur për shkak të numrit të pamjaftueshëm të zyrtarëve komunal në departamentin e tatimit në pronë.

**Ndikimi** Inspektimi i ulët i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

**Rekomandimi C2** Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në RVF e pasurive kapitale ishte 77,308,618€, pasurive jokapitale ishte 732,592€ si dhe e stoqeve 783€.

#### Çështja B1 - Dobësi në menaxhimin e pasurive jo kapitale

**Gjetja** Rregullorja MF-Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, Neni 6 paragrafi 3 përcakton se "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria" dhe neni 22 paragrafi 3 përcakton se " Të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit".

Komuna kishte regjistruar pasurinë jo kapitale në sistemin e-pasuria, mirëpo sistemi nuk kishte llogaritur zhvlerësimin. Përveç kësaj kemi identifikuar se katër (4) pagesa, në vlerë 21,290€, nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria.

Dobësitë e identifikuara kanë ndodhur për shkak se sistemi nuk kishte llogaritur zhvlerësimin e pasurive, si dhe pakujdesisë së zyrtarit të pasurive për t'i regjistruar të gjitha pasuritë komunale në sistem.

**Ndikimi** Mos llogaritja e zhvlerësimit të pasurive jo kapitale si dhe mosregjistrimi i plotë i tyre, ndikon që pasuritë jo kapitale të mos raportohen në pajtim me kërkesat ligjore.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për regjistrimin dhe raportimin e pasurisë jo kapitale në përputhje me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>4</sup>	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>8,782,599</b>	<b>9,086,394</b>	<b>8,653,621</b>	<b>9,025,466</b>	<b>8,111,517</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	8,135,944	7,886,207	7,839,535	8,499,061	7,346,664
Financimi përmes huamarrjes	0	23,449	22,929	66,825	38,481
Të bartura nga viti i kaluar	0	506,353	365,273	145,987	258,549
Të hyrat vetanake	646,655	646,655	404,714	302,734	461,818
Donacionet vendore	0	23,730	21,169	10,859	6,005

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 303,795€. Kjo rritje është rezultat i rishikimit të Ligjit të Buxhetit, Vendimeve të Qeverisë, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak, financimit nga huamarrja si dhe donacioneve.

Në vitin 2021 Komuna ka shpenzuar rreth 95% të buxhetit përfundimtar. Kjo paraqet një performancë të mirë buxhetore.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>8,782,599</b>	<b>9,086,394</b>	<b>8,653,621</b>	<b>9,025,466</b>	<b>8,111,517</b>
Pagat dhe mëditjet	5,289,706	5,058,048	5,058,048	5,232,500	4,959,252
Mallrat dhe shërbimet	800,000	846,215	826,344	1,725,418	824,638
Komunalitë	212,769	204,964	188,597	183,233	140,476
Subvencionet dhe transferet	250,000	304,189	300,804	230,235	215,418
Investimet Kapitale	1,980,125	2,672,979	2,279,828	1,654,079	1,971,734
Rezervat	250,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 231,658€, krahasuar me buxhetin fillestar. Sipas përgjigjes nga zyrtarët komunal, Komuna nuk kishte arritur të bëjë rekrutimin e stafit të lejuar me ligjin për ndarjen buxhetore për shkak se Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore i cili menaxhohet nga Ministra e Punëve të Brendshme nuk ishte funksionale në të gjitha modulet për t'i zhvilluar procedurat e rekrutimit, me ç'rast qeveria me vendim nr.11/52 datë 29.12.2021 i kishte marr Komunës mjetet në vlerë 249,787€. Përveç zvogëlimit kishte rritje të buxhetit nga fondi i huamarrjes në vlerë prej 18,129€, mjete këto të cilat janë shpenzuar sipas vendimeve të qeverisë për shtesa në shëndetësi gjatë pandemisë.

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 46,215€. Rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2020 20,000€, rritje nga granditë e qeverisë në vlerë 22,555€, ku me vendim nga Kuvendi Komunal ishin transferuar nga kategoria komunale dhe investime kapitale në mallra dhe shërbime, rritje nga donacionet për 2,400€ si dhe nga huamarrja 1,260€. Këto mjete kryesisht ishin planifikuar të shpenzohen për mirëmbajtjen e rrugëve, mirëmbajtja e ndriçimit publik, sinjalizimi horizontal dhe vertikal, mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara publike, mirëmbajtjen e objekteve arsimore, furnizime shëndetësore etj.

Buxheti final për shpenzime komunale ishte zvogëluar për 7,805€, krahasuar me buxhetin fillestar. Zvogëlimi kishte ndodhur me vendim nga Kuvendi Komunal për transfer të mjeteve buxhetore nga granditë e qeverisë në kategorinë mallra dhe shërbime për parandalimin e COVID-19 dhe kryesisht për dezinfektimin e objekteve.

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për subvencione ishte rritur për 54,189€, nga kjo vlerë: 32,706€ janë rritje nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2020, 21,183€ janë rritje nga granditë e donatorëve dhe 300€ nga granditë e qeverisë. Mjetet ishin planifikuar të shpenzohen kryesisht në subvencionimin e fermerëve.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 692,854€. Rritja ishte si rezultat i të hyrave vetjake të pashpenzuara nga viti 2020 në vlerë 453,647€, rritje prej 4,060€, nga fondi i huamarrjes, rritje prej 147€ nga granditë e donatorëve. Përveç kësaj Kuvendi Komunal me vendim për transferin e mjeteve buxhetore, mjetet 250,000€ nga rezervat e Komunës i kishte transferuar në kategorinë investime kapitale për projektin "Ndërtimi dhe rregullimi i Çarshisë së vjetër" (200,000€) dhe "Ndërtimi dhe funksionalizimi i objektit për banim social" (50,000€). Më tutje, me vendim të Kuvendit Komunal të datës 31.08.2021, 15,000€ ishin transferuar nga kategoria investime kapitale në kategorinë mallra dhe shërbime.


Buxheti shtesë në kategorinë investime kapitale ishte planifikuar të shpenzohen kryesisht për projektet: Shtrimi i rrugëve lokale, Ndërtimi, rikonstruktimi dhe mirëmbajtja e banesave sociale, Ndërtimi i hapësirave publike, Ndërtimi i objekteve shëndetësore, ndriçimi publik.

Siç u cek më lart rezerva komunale prej 250,000€, me vendim të Kuvendit Komunal të datës 29.04.2021 ishte transferuar për shpenzim në kategorinë investime kapitale.

Mjetet e shpenzuara në vitin 2021 për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 170,813€, ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në arsim,shëndetësi dhe zjarrfikës.



Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat vetjake të realizuara nga Komuna në 2021 ishin në vlerë 802,799€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, Komuna këtë vit ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku, gjobat e gjykatës dhe nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës në vlerë totale prej 167,107€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>646,655</b>	<b>646,655</b>	<b>802,799</b>	<b>561,138</b>	<b>577,192</b>
Të hyrat tatimore	324,705	324,705	374,793	263,487	293,013
Të hyrat jo tatimore	321,950	321,950	428,006	297,651	284,178

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 kishte rezultuar me gjashtë (6) rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Gjithashtu, raporti i auditimit për vitin 2020 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, tre (3) rekomandime ishin zbatuar, një (1) nuk ishte zbatuar ende si dhe dy (2) pjesërisht ishin zbatuar siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arrijten e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. Përmirësimi në mbledhjen e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Po ashtu, Kryetari duhet të shtojë kontrollet që të sigurojë se bëhet vlerësimi i saktë i tatimit në pronë për taksa paguesit, dhe në raste të ankesave të mundshëm ato të shyrtohen brenda afateve ligjore.	Komuna edhe për vitin 2021, nuk kishte arrit ta bëjë inspektimin e 20% të objekteve komunale. Sa i përket faturimit në mostrat tona nuk kemi hasur ndonjë mangësi.	Pjesërisht i zbatuar

2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj përmes menaxherit të financave se drejtoritë që mbledhin të hyra bashkëpunojnë ngushtë me zyrtarin e të hyrave në mënyrë që të eliminohen këto gabime dhe të hyrat të regjistrohen në SIMFK sipas kodit përkatës të të hyrave në pajtim me planin kontabël.	Nuk kemi hasur ndonjë parregullsi të kësaj natyre.	I zbatuar
3.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë respektimin e rregullave të prokurimit, në lidhje me menaxhimin e kontratave. Gjithashtu edhe menaxheri i kontratës duhet të veprojë në bazë të kompetencave me qëllim të respektimit të rregullave dhe mos tejkalimit të kompetencave dhe sa herë që paraqitet nevoja për ndryshime të kontratës të bëjë kërkesë për aprovim të ndryshimeve duke arsyetuar kërkesën për ndryshim dhe marrë aprovimet e duhura.	Nuk kemi vërejtur mangësi të tilla gjatë auditimit.	I zbatuar
4.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme në mënyrë që sistemi e-pasuria të jetë funksional. Po ashtu duhet të mbahen evidenca që tregojnë se regjistrat e pasurive janë të plotë dhe saktë duke siguruar që vlera e prezantuar e pasurive nën 1,000€ në PFV shpalos vlerën reale të pasurive me të cilën disponon komuna.	Edhe për vitin 2021 kemi hasur çështje të natyrës së njëjtë kur pasuria nuk ishte regjistruar dhe nuk ishte llogaritur zhvlerësimi nga sistemi.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari në bashkëpunim me ZKF-në duhet të sigurojë nga drejtoritë përkatëse, evidencë të saktë të LLA duke raportuar në baza të rregullta për gjendjen e tyre. Këto llogari të arkëtueshme duhet të përcillen me një kujdes të veçantë nëpër vite. Çështja e pagesës së borxheve të vjetra të ish-ndërmarrjeve shoqërore duhet të gjejë një formë të përshtatshme të realizimit/arkëtimit të tyre bazuar në marrëveshjet e arritura me tatimpaguesit.	Nuk kemi hasur mangësi në prezantimin e llogarive të arkëtueshme në RVF.	I zbatuar

6.	Detyrimet Kontingjente	Kryetari duhet të siguroj që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që informatat e shpalosura në PFV në lidhje me të hyrat indirekte dhe detyrimet kontingjente janë të plota dhe konsistente nëpër vite.	Rekomandimi që është dhënë për PFV-të e vitit të kaluar lidhur me prezantimin e drejtë të hyrave indirekte dhe detyrimeve kontingjente është pjesërisht i zbatuar sepse pjesa e rekomandimit që ndërlidhet me të hyrat indirekte është zbatuar, ndërsa sa i përket pjesës tjetër të rekomandimit që ndërlidhet me detyrimet kontingjente mbetet i pazbatuar.	Pjesërisht i zbatuar
----	------------------------	---	--	----------------------


Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Florim Beqiri, Udhëheqës i ekipit



Faik Thaqi, Anëtar i ekipit



Arben Hundozi, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
<p>Në katër (4) raste kemi vërejtur se Komuna ka lëshuar dokumentacionin e tenderit pa hartuar projektin ekzekutues. Rastet ishin tek kontratat: Ndërtimi i shtegut të çiklistëve dhe trotuarit në fshatin Shtrazë në vlerë 86,167€, Rregullimi i trotuarit Bob-Doganaj në vlerë 134,334€, Rregullimi i ndriçimit Publik në vlerë 73,555€, dhe Rehabilitimi i rrugës Qamil Ilazi dhe Sali Bajra, në vlerë 259,937€.</p>	<p>Mjetet buxhetore të Komunës së Kaçanikut kufizojnë mundësinë për hartimin e projekteve të detajuara nga kompanitë projektuese për secilin projekt të koduar në listën e miratuar vjetore për investime kapitale. Si rrjedhojë, Komuna e Kaçanikut detyrohet për projektet të caktuara, si trotuare që shtrihen përgjatë traseve të rrugëve ekzistuese, shtrirjen e rrjeteve të ndriçimit publik në shtyllat ekzistuese të energjisë elektrike a po rehabilitim të rrugëve ekzistuese të angazhon staf profesional të drejtorive komunale (inxhinieret e fushave përkatëse) në përgatitjen e dosjeve të tenderëve për projektet e caktuara.</p>	<p>Komuna në këtë rast ka bërë vetëm arsyetim pa ofruar ndonjë dëshmi, prandaj Komuna t'i respektoj kërkesat ligjore duke hartuar projektin ekzekutues i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet Specifikave Teknike.</p> <p>Gjetja mbetet e pandryshuar.</p>
<p>Komuna kishte regjistruar pasurinë jo kapitale në sistemin e-pasuria, mirëpo sistemi nuk kishte llogaritur zhvlerësimin. Përveç kësaj kemi identifikuar se katër (4) pagesa, në vlerë 21,290€, nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria.</p>	<p>Pranojmë që disa pagesa nuk kemi arritur t'i regjistrojmë, mirëpo nuk mund të pajtohemi me pjesën tjetër ku thuhet se nuk është llogaritur zhvlerësimi. Sistemi E-pasuri menaxhohet në tërësi nga Ministria dhe ne nuk mund të ndërhyjmë aspak te opsionet për kalkulimin e zhvlerësimit. Ky sistem nuk ka qenë në funksionim ashtu siç duhet sidomos gjatë dy viteve të fundit.</p>	<p>Te kjo çështje në kuadër të gjetjes edhe ne e kemi evidentuar se sistemi e-pasuria nuk kishte llogaritur zhvlerësimin. Gjetja mbetet e pandryshuar.</p>

<p>Detyrimet kontingjente të prezantuara në nenin 18 në Raportin Vjetor Financiar (RVF) janë paraqitur në vlerë 100,511€, derisa sipas regjistrit të mbajtur nga përfaqësuesi ligjor i Komunës kishin vlerën 515,057€. Kjo situatë tregon se detyrimet kontingjente ishin të nënvlerësuara për 414,546€.</p>	<p>Komuna e Kaçanikut ka shumë konteste gjyqësore të natyrave të ndryshme, ku shumë prej paditësve nuk kanë asnjë bazë, por janë vetëm pretendime. Me Më datën 28.01.2022 kemi dërguar te drejtorja e financave për paraqitjen në Pasqyra Vjetore një listë me detyrime kontingjente që kemi menduar se mund të përfundojnë gjatë vitit, por asnjëra nuk ka përfunduar, për arsye se procedurat kontestimore dihet vetëm kur fillojnë dhe mund të zgjasin me vite të tëra. Në atë shkresë kemi potencuar se ka edhe shumë lëndë të tjera, nuk janë vetëm këto. Pastaj gjatë procesit të auditimit nga ZKA në komunën tonë, më datën 29.04.2022 me kërkesë të auditorit kemi dorëzuar një listë më të zgjeruar ku përfshinë padi të viteve të ndryshme, po ashtu kemi dorëzuar edhe pesë padi në kopje fizike. Siç shihet edhe në këto 5 procedurat e fundit, paditësit nuk kanë asnjë bazë ligjore, por ato janë vetëm pretendime të paditësit. Bazuar në argumentin e përmendur më lartë, Kryetari i Komunës kërkon që të rishqyrtohet edhe një herë kjo e gjetur e Auditorit, e cila edhe ka ndikuar në Opinion të Kualifikuar të Pasqyrave Financiare për vitin 2021 të Komunës sonë.</p>	<p>Në raportin e auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2020 ishin identifikuar probleme të natyrës së njëjtë me rastin e prezantimit të detyrimeve kontingjente duke mos i prezantuara detyrimet e vitit paraprak, me ç'rast ZKA kishte rekomanduar që detyrimet kontingjente duhet të jenë të plota dhe konsistente nëpër vite. Komuna nuk e ka trajtuar me seriozitet rekomandimin e dhënë të vitit 2020, dhe si rezultat ka rezultuar me nënvlerësimin e detyrimeve kontingjente prej 414,546€, në RVF të vitit 2021. Në RVF Komuna duhet të bëjë prezantimin e plotë të detyrimeve kontingjente e jo vetë pretendimet të cilat priten të përfundojnë brenda vitit. Gjetja mbetet e pandryshuar.</p>
--	--	--

<p>Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë 104,879€. Nga kjo vlerë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- nga kategoria investimet kapitale janë paguar 87,562€, për mirëmbajtjen teknike të objekteve komunale dhe riparimin e objekteve shkollore, të cilat sipas udhëzimit konsiderohen mallra dhe shërbime;</li> <li>- nga kategoria mallra dhe shërbime vlera prej 15,637€, ishte paguar nga Thesari sipas vendimit përmbarimor për shpronësimin e tokës shpenzime këto që i takojnë kategorisë investime kapitale; dhe</li> <li>- nga kategoria mallra dhe shërbime janë paguar 1,680€, për pagat e arsimtarëve të angazhuar gjatë pandemisë Covid-19.</li> </ul>	<p>Shuma e ndodhur e keqklasifikimit prej 15,637 euro ka ndodhur përmes Vendimit Përmbarimor dhe ekzekutimin në këto raste e bënë MFPT Thesari i Kosovës.</p> <p>Mjetet tjera të cilësuar si keqklasifikim i shpenzimeve kanë rrjedhur nga shpenzimi i mjeteve tek kodet e projekteve kapitale siç edhe ekzistojnë vite me radhë në listën e projekteve kapitale pra projekti me kod 86363 "Rinovimi i objekteve dhe infrastrukturës shkollore" etj, ku për herë të parë Auditori ZKA cilëson si mallra dhe shërbime natyrën e realizimit të këtij projekti, nga ekipet tjera të Auditorëve gjithnjë është cilësuar si në rregull, prandaj edhe e kemi mbajtur si kod tek lista e projekteve kapitale.</p> <p>Ne kuptojmë që gjatë procesit të buxhetit duhet ta respektojmë UA MF- Nr. 04/2019 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale, mirëpo bazuar në shkallën e Buxhetit Vjetor prej 9,086,394 euro konsiderojmë se shuma e shpenzimeve të cilësuar si keqklasifikim shprehur në përqindje është mjaft e ulët.</p>	<p>Komuna ka bërë vetëm arsyetim në lidhje me gjetjen e dhënë në raport pa ofruar ndonjë dëshmi. Definimin e projekteve kapitale dhe klasifikimin e shpenzimeve të projekteve kapitale e përcakton shumë qartë udhëzimi administrativ "shpenzimet e operimit, riparimit dhe mirëmbajtjes konsiderohen si shpenzime rrjedhëse" prandaj me rastin e buxhetimit dhe shpenzimit të projekteve kapitale Komuna duhet marr parasysh kërkesat e këtij udhëzimi. Gjetja mbetet e pandryshuar.</p>
--	---	---





**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipal Kaçanik**

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAÇANIK	
Data: 02.06.22	Vendi: KAÇANIK
h. ser.	Numri
01	104/02-14990 -1.

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- NUK pajtohem me disa nga gjetjet dhe rekomandimet dhe kam dërguar komentet për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Besim Ilazi - Kryetar komune

Data: 02. Qershor 2022, Kaçanik.

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>5</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>6</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

**Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinionit i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.

## Shtojca IV: Komentet e komunës në gjetjet e auditimit



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipal Kačanik

### Zyra e Kryetarit

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e OB-së në rast të mospajtimit	Pikëpamja e ZKA-së
<b>Çështja A1 - Keqklasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike:</b> Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve nëpër kategori	<b>Pjesërisht</b>	Shuma e ndodhur e keqklasifikimit prej 15,637.00 euro ka ndodhur permes Vendimit Permbarmorë dhe ekzekutimin ne keto raste e bënë MFPT Thesari i Kosovës.	

<p>ekonomike në vlerë 104,879€. Nga kjo vlerë:  - nga kategoria investimet kapitale janë paguar 87,562€, për mirëmbajtjen teknike të objekteve komunale dhe riparimin e objekteve shkollore, të cilat sipas udhëzimit konsiderohen mallra dhe shërbime;  - nga kategoria mallra dhe shërbime vlera prej 15,637€, ishte paguar nga Thesari sipas vendimit përbarimor për shpronësimin e tokës shpenzime këto që i takojnë kategorisë investime kapitale; dhe nga kategoria mallra dhe shërbime janë paguar 1,680€, për pagat e arsimtarëve të angazhuar gjatë pandemisë Covid-19. Këto kishin ndodhur për shkak të planifikimit jo të mirë buxhetor dhe mungesës së mjeteve në kategoritë adekuate.</p>		<p>Mjetet tjera të cilësuar si keqklasifikim i shpenzimeve kanë rrjedhur nga shpenzimi i mjeteve tek kodet e projekteve kapitale siq edhe ekzistojnë vite me radhë në listen e projekteve kapitale pra projekti me kod 86263 "Renovimi i objekteve dhe infrastruktures shkollore" etj, ku për here të parë Auditori ZKA cilëson si mallra e shërbime natyren e realizimit të ketij projekti, nga ekipet tjera të Auditoreve gjithnjë është cilësuar si në rregull, prandaj edhe e kemi mbajtur si kod tek lista e projekteve kapitale.</p> <p>Ne kuptojmë që gjatë procesit të buxhetimit duhet ta respektojmë UA MF-Nr.04/2019 per Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale, mirepo bazuar ne shkallën e Buxhetit Vjetor prej 9,086,394.00 euro konsiderojmë se shuma e shpenzimeve të cilësuar si keqklasifikim shprehur ne perqindje eshte mjaft e ulët.</p>
--	--	--

<p><b>Çështja A2 - Regjistrimet e gabuar të pasurive kapitale:</b></p> <p>Pasuritë kapitale të prezantuara në nenin 19.3.1 në RVF ishin të mbivlerësuar për 101,407€, pasi që pagesat e mëposhtme ishin regjistruar si pasuri kapitale ndonëse i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime. Pagesat në vlerë 56,999€ dhe 17,084€ për renovimin e objekteve shkollore, pagesa në vlerë 13,479€ për renovimin e objekteve banesore, pagesa në vlerë 6,695€ për furnizim me oxygen concentrator, pagesa në vlerë 5,990€ për furnizim me inventar për shkolla dhe pagesa në vlerë 1,160€ për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave. Mbivlerësimi i pasurive kapitale ka ndodhur pasi që zyrtari i pasurisë gabimisht i kishte regjistruar si pasuri kapitale në SIMFK, pasuritë që nuk e plotësojnë kriterin për të</p>	<p>P0</p>	
---	-----------	--



<p>qenë pasuri kapitale.</p>			
<p><b>Çështja C1 - Nënvlërësimi i detyrimeve kontingjente:</b></p> <p>Detyrimet kontingjente të prezantuara në nenin 18 në Raportin Vjetor Financiar (RVF) janë paraqitur në vlerë 100,511€, derisa sipas regjistrit të mbajtur nga përfaqësuesi ligjor i Komunës kishin vlerën 515,057€. Kjo situatë tregon se detyrimet kontingjente ishin të nënvlerësuara për 414,546€.</p> <p>Paraqitja e detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ka rrjedhur si rezultat i të kuptuarit jo të drejtë të kërkesës së rregullës nga përfaqësuesi ligjor i Komunës, i cili me rastin e përgatitjes së RVF kishte ofruar vetëm regjistrin e detyrimeve kontingjente me pretenduesit për të cilat priten që kontestet gjyqësore të</p>	<p><b>JO</b></p>	<p>Komuna e Kaçanikut ka shumë konteste gjyqësore të natyrave të ndryshme, ku shumë prej paditësve nuk kanë asnjë bazë, por janë vetëm pretendime. Më datën 28.01.2022 kemi dërguar te drjtoria e financave per paraqitje në Pasqyra Vjetore një listë me detyrime kontigjente që kemi menduar se mundë të përfundojnë gjatë vitit, por asnjëra nuk ka përfunduar, për arsye se procedurat kontestimore dihet vetëm kur fillojnë dhe mundë të zgjasim me vite të tëra. Në atë shkresë kemi potencuar se ka edhe shumë lëndë të tjera, nuk janë vetëm këto. Pastaj gjatë procesit te Auditimit nga ZKA ne komunen tonë, më datën 29.04.2022 me kërkesë të auditorit kemi dorëzuar një listë më të zgjeruar ku përfshinë padi të viteve të ndryshme, po ashtu kemi dorëzuar edhe pesë padi në</p>	

<p>zgjidhen brenda vitit 2021.</p>	<p>kopje fizike, siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Padia e Halim Shurdhani nr. 85/19 që është në Gjykatë të Apelit;</li> <li>-Padia e Lule Rakës nr. 117/21 ë është mbajtur vetëm një seancë në shkallë të parë;</li> <li>-Padia e Ilaz Krasniqit nr. 162/17 që akoma janë duke u zhvilluar seanca në Gjykatën Themelore;</li> <li>-Procedura përbarimore me kreditorin “Lunari Company” P.nr.320/2021, ku kreditori është tëheqë nga kjo procedurë, si dhe</li> <li>-Procedura përbarimore me kreditorin “Luboteni-A” shpk P.nr.08/21, ku në bazë të Memorandum Mirëkuptimit debitor duhet të ishte Ministria, e jo Komuna e Kaçanikut dhe për këtë arsye kemi bërë prapësim.</li> </ul> <p>Siç shihet edhe në këto 5 procedurat e fundit, paditësit nuk kanë asnjë bazë ligjore, por ato janë vetëm pretendime të paditësit. Procedurat për seanca për</p>	
------------------------------------	--	--

		<p>paditë e Lule Rakës, Ilaz Krasiqit posa kanë filluar në shkallë të parë dhe nuk dihet se kur përfundojnë, ndërsa kreditori "Lunari Company" ka tërheq urdhrin përbarimor.</p> <p>Bazuar në argumentin e permendur me lartë, kryetari i komunës kërkon që të rishqyrtohet edhe nje here kjo e gjetur e Auditorit, e cila edhe ka ndikuar ne Opinion te Kualifikuar të Pasqyrave Financiare per vitin 2021 te Komunes sonë.</p>	
<p><b>Çështja A3 - Tejkalim i kontratës publike kornizë:</b></p> <p>Te dy kontratat publike kornizë të lidhura me çmim për njësi kemi identifikuar, se pagesat totale për projektet kanë tejkalim të vlerës së kontraktuar. Tejkalimet janë vërejtur te kontrata "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale" e lidhur me 15.11.2019, në vlerë 450,000€,</p>	<p>PO</p>		

<p>tejkalimi ishte në vlerë 134,930€, dhe te kontrata "Rregullimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit vertikal dhe horizontal" e lidhur me 21.11.2019, në vlerë 70,000€, tejkalim ishte në vlerë prej 18,265€.</p> <p>Tejkalimi i kontratave kishte ndodhur për shkak se zyra e prokurimit me rastin e hartimit të kontratave gabimisht e kishte paraparë në kontratë aplikimin e pragut apo tavanit plus/minus tridhjetë përqind (30%).</p>			
<p><b>Çështja A4 - Mungesa e projektit ekzekutues:</b></p> <p>Në katër (4) raste kemi vërejtur se Komuna ka lëshuar dokumentacionin e tenderit pa hartuar projektin ekzekutues. Rastet ishin tek kontratat: Ndërtimi i shtegut të çiklistëve dhe trotuarit në fshatin Shtrazë në vlerë 86,167€, Rregullimi i trotuarit Bob-Doganaj në vlerë 134,334€, Rregullimi i ndriçimit Publik në vlerë</p>	<p>Pjeserisht</p>	<p>Mjetet buxhetore te komunes se Kaçanikut kufizojne mundesine per hartimin e projekteve te detajuara nga kompani projektuese per secilin projekt te koduar ne listen e miratuar vjetore per investime kapitale.</p> <p>Si rrjedhoje, komuna e Kaçanikut detyrohet qe per projekte te caktuara, si trotuare qe shtrihen pergjate traseve te rrugeve ekzistuese, shtrirjen e rrjeteve te ndriçimit publik ne shtyllat ekzistuese te energjise</p>	

<p>73,555€, dhe Rehabilitimi Sali Bajra, në vlerë 259,937€. Kjo ka ndodhur nga pakujdesia e Komunës për të hartuar projektin ekzekutues ashtu siç kërkohet me kërkesat ligjore.</p>		<p>elektrike apo rehabilitim të rrugeve ekzistuese, të angazhon stafin profesional të drejtorive komunale (inxhinieret e fushave perkatese) në përgatitjen e dosjeve të tendereve për projekte të caktuara.</p>	
<p><b>Çështja C2 - Mosverifikimi i plotë i pronave komunale:</b> Komuna e Kaçanikut kishte faturuar Tatimin në Pronë nga sistemi i Protax për objekte 9105 fatura. Komuna në vitin 2021 kishte arritur të bëjë inspektimin (verifikimin) e 550 objekteve apo rreth 6% të objekteve. Verifikimi i ulët i pronave ka ndodhur për shkak të numrit të pamjaftueshëm të zyrtarëve komunal në departamentin e tatimit në pronë</p>	<p>PO</p>	<p>Gjatë periudhës së fundit dy vjeqare në sikurse gjitha OB-ët tjera kemi pasur veshitësi në rekrutimin e stafit, konkretisht nuk kemi mundur të rekrutojmë staf të ri pas daljes në pensionim të stafit të kaluar.  Verifikimin e pronave bazuar në Ligjin Nr.06/L-005 për Ttimin në Pronë kemi mundur ta realizojmë përmes angazhimit me kontrata me afat të caktuar siq edhe po veprojnë disa OB, mirepo kemi vendosur ta respektojmë Ligjin e Punes I cili ligj ndalon rreptesisht angazhimin e stafit përmes kontratave të ashtuquajtura Kontrata në Veper.</p>	
<p><b>Çështja B1 - Dobësi në</b></p>	<p>Pjesërisht</p>	<p>Pranojmë që disa pagesa nuk</p>	

<p><b>menaxhimin e pasurive jo kapitale:</b></p> <p>Komuna kishte regjistruar pasurinë jo kapitale në sistemin e-pasuria, mirëpo sistemi nuk kishte llogaritur zhvlerësimin. Përveç kësaj kemi identifikuar se katër (4) pagesa, në vlerë 21,290€, nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria. Dobësitë e identifikuara kanë ndodhur për shkak se sistemi nuk kishte llogaritur zhvlerësimin e pasurive, si dhe pakujdesisë së zyrtarit të pasurive për t'i regjistruar të gjitha pasuritë komunale në sistem.</p>		<p>kemi arritur ti regjistrojmë, mirepo nuk mund te pajtohemi me pjesen tjeter ku thuhet se nuk eshte llogaritur zhvleresimi. Sistemi E-pasuri menaxhohet ne teresi nga Ministria dhe ne nuk mund te nderhyjme aspak te opcionet per kalkulimin e zhvleresimit.</p> <p>Ky sistem nuk ka qene ne funksionim ashtu siq duhet sidomos gjate dy viteve te fundit.</p>	
---	--	---	--

**KRYETARI I KOMUNES**

BESIM ILAZI




KAÇANIQ, 01.06.2022